

A VIEW ON SOME ALBANIAN AND GERMAN EUPHEMISMS

SPROVË MBI DISA EUFEMIZMA TË SHQIPES DHE GJERMANISHTES

Izmit DURMISHI¹

¹ Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: izmit.durmishi@unite.edu.mk

Abstract

Euphemisms are words or linguistic expressions that are used instead of another word or expression, which we do not want to use or should not be used (e.g. 'gojëlidhuri' for "the wolf"; *he left us* instead of "died" etc.). So, euphemisms are usually called all those words and expressions that substitute the rude and improper words with lighter and softer words and expressions.

We find such euphemistic words and expressions in Albanian and other languages, even German. We mainly encounter them in the vernacular, however, recently, due to their widespread use and the importance that they have in communication, they are increasingly becoming an important topic of semantic research, pragmatic linguistics and, in particular, of sociolinguistic researches, meanwhile, in some languages they have become the basic subject of lexicographical works.

Keywords: language, report, society, euphemisms, linguistic expression, research, etc.

Përmbledhje

Eufemizmat janë fjalë ose shprehje gjuhësore që përdoren në vend të një fjale a shprehjeje tjetër, të cilën nuk duam ose nuk duhet ta zëmë në gojë (p.sh. gojëlidhuri për "ujkun"; u nda prej nesh në vend të "vdiq" etj.). Pra, eufemizma quhen zakonisht gjithë ato fjalë e shprehje, që zëvendësojnë fjalë të vrazhda e të pahishme me fjalë e shprehje më të lehta e më të buta.

Fjalët dhe shprehjet e tilla eufemistike i takojmë në shqipen dhe gjuhë të ndryshme, pra edhe në gjermanishten. Ato kryesisht i hasim në gjuhën popullore, megjithatë, kohëve të fundit, për shkak të përdorimit të gjerë të tyre dhe rëndësisë që kanë në komunikim, gjithnjë e më tepër po bëhen temë e rëndësishme e kërkimeve semantike, gjuhësisë pragmatike e në mënyrë të veçantë e hulumtimeve sociolinguistike, ndërkaq, në disa gjuhë janë bërë lëndë bazë e veprave leksikografike.

Fjalë kyçe: gjuhë, raport, shoqëri, eufemizmat, shprehje gjuhësore, hulumtim etj.

Hyrje

Që në fillim duhet pohuar se përdorimi i gjuhës është i lidhur ngushtë me shoqërinë, prandaj edhe përdorimi i eufemizmave duhet parë në një kontekst më të gjerë shoqëror. Gjuhëtari ynë i shquar, Eqrem Çabej që në fillim të herës e kishte shtjelluar problemin e eufemizmave të shqipës në një kuadër të gjerë e të hapët, duke krahasuar ato edhe me eufemizmat e gjuhëve të Ballkanit e më gjerë.

Ai kishte vërejtur se eufemizmat si dukuri gjuhësore që i takojmë në shqipen, po edhe në gjuhët e tjera, kanë shtrirje të madhe sidomos në të folmet popullore. Që këtu mund të kuptojmë ndërlidhjen e ngushtë të këtyre shprehjeve gjuhësore figurative me shtresat popullore. Edhe pse ende nuk janë bërë sa duhet kërkime në lëmin e sociolinguistikës e aq më pak vlerësime kritike, një gjë është e sigurtë se gjuhësia për ditë e më shumë po u kthehet shqyrtimeve sociolinguistike, gjë që është mjaft e vlefshme për gjuhësinë (sociolinguistikën shqiptare)².

Eufemizmat dhe shoqëria: pasqyrimi i mendësisë dhe botës shpirtërore të grupimeve shoqërore në emëritmin e disa dukurive në mënyrë të tërthortë ose eufemistike. Këtu, natyrisht, duhet të nisemi nga postulate të tilla si ai që kanë parashtruar Braun e Levinson që thonë: “Eufemizmat janë shenjues universalë të përdorimit të gjuhës“³. Eufemizmat janë kategori e njohur edhe në gjuhë të tjera, pra edhe në gjermanishten. Që në lashtësi eufemizmat janë përdorur me qëllim që njerëzit të mos i thërrisnin sendet në emrin e tyre, për arsye bestytnie a mendësie. Kështu për djallin (dreqin, shejtanin) në gjermanisht përdornin emërtimin eufemistik: “der Schwarze”(i ziu), “der Pferdefuß” (këmbë kalë), “der Böse” (i ligu).

Funksione eufemistike kanë në gjermanishten edhe të gjitha fjalët, që emërtojnë dukuri shoqërore negative (*verhüllen, verdecken* (përshtjell, mbuloj, fsheh), *aufbessern* (përmirësoj)). Në këtë grup hyjnë edhe disa fjalë jo të vjetra, si p.sh. përkrah fjalës “Seniorenwohnheim” (azil për pleqtë) gjejmë fjalët: “*Altersheim*”, “*Altenheim*”, “*Feierabendheim*”; po kështu për fjalën “*Schulspeisung*”- “*Kinderspeisung*” (mensä në shkollë); “*Arbeitslosigkeit*” – *Nullarbeit, gesundschumpfen* (papunësi). Nuk mungojnë në gjermanishten eufemizma për situata shëndetësore a sëmundje, jo vetëm tradicionale, po edhe të sotme, si: *Krüppel* – *Körperbehinderter* – *Gehbehinderter* (invalid, sakat); *Mord- Selbstod* – *Freitod* (vdekje).

Si eufemizma në gjuhën gjermane shërbejnë edhe fjalë, të cilat kanë ardhur nga gjuhë të huaja, si p.sh. *Verfehlung* për *Verbrechen* (krim); *eigenartig* për *originell*; *einschätzen- werten* – *bewerten*; *Sterben* (vdes)- *einschlafen*, *Augen schließen*, *heimgehen*, *einschlummern*; *von der Bühne abtreten*, *vom Schauplatz abtreten*, *den Geist aufgeben*, *ins Gras beißen*. Për të thënë që një femër është shtatzanë: *in anderen Umständen sein* – *schwanger*; po ashtu për lidhje dashurie: *ein Verhältnis haben* – *Liebesbeziehung*. Tabutë në gjuhë janë të pranishme qysh herët, që nga paraqitja e mendimit religjioz – fjalë të caktuara si p.sh. fjala *Zot*, nuk është lejuar të përmendet me gojë, as të shkruhet.

Nga emërtimet e tipit “Tabu” në gjermanishten mund të përmendim emrat e qenieve të mbinatyrshme: p.sh. çifutët për zotin, në mënyrë tërthortë nga “*Gott*” ata përdornin fjalën “*Herr*” (zotëri). Edhe për fjalën “*Teufel*” (djall) janë gjetur shumë eufemizma, p.sh.: “*Satan, Satanas, Luzifer, Beelzebub, Versucher, Antichrist, der Böse*” etj. Edhe në mjediset shqiptare, sikundër ka theksuar prof. Gj. Shkurtaj, fjala *Zot*, ka pasur gjithandej zëvendësime me shprehje perifrastike eufemistike, si p.sh. në Malësi të Mbishkodrës: për atë që qoftë lëvdue, *pasha jata ç'i ma ka falë shpirtin, pasha atë që vranë e kthiell, pasha atë që ëshë një e z'bahen dy; pasha ata ç'i asht nja e z'bahen dy* (për atë që është një e s'ka të dytë) etj.⁴

² Shih: Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999, f.241-254

³ Brown & Lewinson, *Politeness: some universals in language usage*, Cambridge, 1987, f. 216

⁴ Shih: Gj. Shkurtaj, *Vështrim sociolinguistik për fjalët zot, perendi, allah* (Sprovë për një shqyrtim paraprak), në “*Sociolinguistika*”, SHBLU, Tiranë, 2003, f.230.

Shumë lehtë mund të bëjmë krahasime të ngjashme edhe sot e kësaj dite edhe atë, jo vetëm në jetën private po edhe në atë publike. Meqë vlerat⁵ shoqërore përmes tabuve të cilat janë të llojllojshme, në disa bashkësi shoqërore, ndikojnë në përdorim e gjuhës, disa fjalë aspak nuk përdoren ose nuk thuhet me kuptimin e tyre burimor. P.sh. prof. Shkurtaç ka theksuar se “një mënyrë e mospërmendjes së fjalës zot, ka qenë edhe përdorimi i togfjalëshave të mangët, ku fjala zot elidohet enkas: *per bes* (<për besë të Zotit), *për t’drejt* (<për të drejtën e Zotit), *paj qebesa* (paj qe besa e Zotit)”⁶.

Megjithatë, pa marrë parasysh se për çfarë lloj të tabush është fjala, të gjitha shoqëritë kanë një mënyrë të veçantë në shpjegimin e kuptimit të tyre, duke shfrytëzuar në mes tjerash edhe eufemizmat⁷. Gjuha është mjet komunikimi e ndërlidhur ngusht me shoqërinë: “ajo si praktikë njerëzore është gërshtuar fuqishëm në institucionet shoqërore, kulturore dhe civilizuese dhe, në pikëmpamje dhe shkallë të ndryshme” ajo figuron në traditën filozofike të Lindjes dhe të Perëndimit “, theksonte Bugarski⁸.

Është i pamohueshëm fakti se përdorimi i gjuhës është i lidhur ngusht me shoqërinë, prandaj edhe përdorimi i eufemizmeve duhet parë në një kontekst më të gjerë shoqëror. Nisur nga ky fakt, eufemizmat nuk janë vetëm temë pragmalinguistike, por edhe sociolinguistike, të cilën më së miri e ilustron skema vijuese:

EUFEMIZMI -----> GJUHA --- ----> SHOQËRIA

Eufemizmat dhe përvetësimi i njohurive për to, janë një lojë e vazhdueshme midis gjuhës dhe shoqërisë. Ato janë ndër mekanizmat dhe shprehjet që flasin bindshëm se gjuha, sidomos në aspektin e saj pragmatik e kjo nënkupton gjatë përdorimit të saj, nuk mund të paramendohet e shkëputur nga shoqëria. E gjithë kësaj i shkon në përputhje edhe me faktin se sociolinguistika si disiplinë “ që studion ndërlidhjet midis të folurit dhe shoqërisë “, mund të japë ndihmesën dhe hapësirat e gjera të saj për të mësuar shumë dukuri e shprehje gjuhësore dhe gjithësesi edhe për eufemizmat, si dukuri kaq e përhapur në bashkësisët shoqërore tradicionale dhe të sotme a moderne.

Sociolinguistika si disiplinë e re shkencore ngadalë po zhvillohet edhe ndër shqiptarët. Ndoshta jo aq sa te popujt e tjerë, megjithatë nuk mungojnë kontributet dhe shqyrtimet për tema të veçanta, si dhe punimet që kanë objekt studimi problemet e ndryshme të lidhjeve dhe shprehjes së ndikimeve e ndërlidhërisë së aspekteve gjuhësore me shoqërinë apo si fryte të sociolinguistikës. Orvatje për të kontribuar në raportet e ndërlidhjes së gjuhës me shoqërinë kanë bërë studiues të ndryshëm, megjithatë, trajtim më të thellë dhe më të veçantë çështjeve sociolinguistike u ka bërë prof. Gj. Shkurtaç, i cili njëherësh është edhe hartues i teksteve të sociolinguistikës universitare si dhe i disa librave kushtuar etnografisë së të folurit, ku, sikundër thotë ai shprehimisht, eufemizmat dhe përgjithësisht ligjërimi grarisht, zënë kryet e vendit në aspektin etnolinguistik dhe sociolinguistik⁹.

Në anën tjetër, rezultate të kënaqshme, gjuhësia shqiptare po shënon kohëve të fundit edhe në një degë specifike të sociolinguistikës – si krijimi dhe problematika lidhur me gjuhën standarde, për normën dhe normëzimin, për politikën gjuhësore në Shqipëri dhe përkatësisht në botën e qytetëruar, detyrat e shoqërisë ndaj njësimimit dhe standardizimit të gjuhëve si faktor ecjeje përpara dhe përbashkimi kulturor e shpirtëror etj.). Mund të përmendim edhe ndihmesa e botime të tilla si ato të profesor Rami Memushajt “Shqipja standarde” (si ta flasim dhe ta shkruajmë), Tiranë, 2002 – 2004; të prof. Gjovalin Shkurtaç: ”Kahe dhe dukuri të kulturës së

⁵ Me vlerë nënkuptojmë përgjithësisht “ atë kategori që është e vlefshme në pikëpamje materiale, morale e shpirtërore”

⁶ Shih: Gj. Shkurtaç, *Vështrim sociolinguistik për fjalët zot, perendi, allah* (Sprovë për një shqyrtim paraprak), në “Sociolinguistika”, SHBLU, Tiranë, 2003, f.230.

⁷ Apte, *Taboo Words*, në: *Concise Encyclopedia of Pragmatics*, Amsterdam, 1998, f.987

⁸ Bugarski R., *Jezik u drushtvu*, Beograd, 1986, f.241

⁹ Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999, f.9; *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004; *Sociolinguistikë e shqipes*, Nga sociolinguistika te etnografia e të folurit, Tiranë, 2009.

gjuhës”, Tiranë, 2004; “Kultura e gjuhës”, Tiranë, 2006, “Si të shkruajmë shqip”, Tiranë, 2008; “Pesha e fjalës shqipe”, Tiranë, 2009 „Urgjenca gjuhësore“, Tiranë 2017; të Xhevat Lloshit: “Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika”, Ribotim, Albas, 2005; të Qemal Muratit: “Standardi gjuhësor dhe kultura e shprehjes”, Prishtinë, 2004; të Shefkije Islamajt: “Gjuha dhe identiteti”, Tiranë, 2008, e shumë të tjera që janë arritje meritore për mbarë kulturën shqiptare e më gjerë.

Nisur nga ky fakt mund të pohojmë se gjuha mbi të gjitha bëhet mjet kryesor apo instrument, që shënon para se së gjithash dukuri të caktuara shoqërore. Sociolinguistika përkufizohet si pjesë e gjuhësisë, e cila trajton të gjitha raportet në mes shoqërisë dhe strukturave gjuhësore, ndërlidhjet midis tyre dhe ndërndikimin a interferencën. Çfarë raportesh midis tjerash trajton sociolinguistika, dhe si i sheh ajo eufemizmat?

Nga studimet e bëra deri më sot, si në kuadrin e gjerë të etnolinguistikës dhe të sociolinguistikës, ashtu edhe në shqyrtimet e reja që janë bërë në mjediset shqiptare, në Shqipëri e më gjerë hapësirave shqiptare në ballkan, madje edhe në diasporën arvanite e arbëreshe, kanë rezultuar disa tema “tabu” për femrat. Akademik Gj. Shkurtaç ka theksuar shprehimisht se janë disa fjalë e shprehje që gratë i kanë pasur të ndaluara t’i përdorin në të folurit e tyre, ndonëse ato, natyrisht, si anëtare të bashkësive të caktuara gjuhësore ku bëjnë pjesë, i dinë.

Edhe për raportet që kanë njerëzit me njëri-tjetrin, përdoren një numër i konsiderueshëm eufemizmash dhe kjo, natyrisht, pasqyron edhe vetitë e tyre morale, sjelljen në shoqëri, qëndrimet dhe konceptet për veset e virtytet. Kështu, për një njeri të keq thuhet është *prapsenë* (Çegran, Toplicë, Sërmnovë, Reçan-Gostivar), *halla-halla, ruajna zot, i çalldisët* (Çajlë, Forinë, Çegran, Vrutok, Raven, Patalisht); tek arbreshët e Italisë siç kanë theksuar edhe prof. Tomor Osmani e prof. Simon Pepa, përdoret edhe eufemizmi *ndjezotël*¹⁰.

Për hajdutin a vjedhësin në shumë lokalitete të Pollogut të Epërm dëgjojmë eufemizmat: *ka dorë, prekës*, si edhe në Shkodër, ndërkaq në Kosovë përdoret eufemizmi *marnjak*. Për një njeri që merr dhe nuk e kthen borxhin dëgjohet eufemizmi *bogxhanli* (Gostivar me rrethinë); *s’ta bjen kurrë, merre kur ta merrish, shihe kur ta shohësh* (Shkodër)¹¹. Për një njeri të shkathët, të gjallë po përdoren eufemizmat: *është cibrak, shejtan, dreç, acar* (Gostivar me rrethinë). Tomor Osmani e Simon Pepa kanë vënë në dukje edhe shprehjet: *është zog asisoit, zogashtushit, i mejdanit*¹²; për një gënjeshtar dëgjojmë: *është dallaverexhi, babe renës*; për një gënjeshtër të madhe thuhet: *na ke flliç* (Gostivar, Tetovë); për një njeri të humbur, të lënë, përdoren eufemizmat: *i hopët, hupët, mos ta pafsha në derë* (Pollog me rrethinë).

Për një fëmijë të urtë, përdoret eufemizmi: *i ka fjug nona shame fterës* (Gostivar me rrethinë), por, mesa duket do të jetë edhe më e shtrirë, sepse prof. Shkurtaç thotë se e ka dëgjuar edhe në Mbishkodër, por atje me tjetër kuptim: *nuk ma ka blua nana ftyrën* (për një njeri që flet pa e frenuar gojën, edhe kur lëshon ndonjë fjalë të rëndë a blasfemi). Ngjajshëm për të paturpshmin dëgjohet gjithashtu eufemizmi: *ka le pa perde* (Çegran, Forinë, Balindoll), që përkon tipologjikisht me shprehjet e mësipërme.

Natyrisht, duke hetuar në praktikën etnografike dhe në përvojat e vjetra të bashkësive shoqërore tradicionale, mund të gjejmë edhe shpjegime që lidhen me zakonet që fëmija i posalindur mbulohet me një shami, shenjë që shpreh pikërisht dëshirën që ai, kur të rritet, të jetë i turpshëm, i përmbajtur, i mbuluar dhe jo gojëlshuar, jo gojështurur. Për të tillët, në Shkodër thuhet: *“i ka plas dielli i marres”*, në Gostivar me rrethinë *“i ka pjas marrja”*. Për një fëmijë të zgjuar në kohët e reja thuhet: *ka le me fakultet* (Gostivar, Tetovë me rrethinë).

Në Kumanovë, Tropojë e Shkodër, për të njëjtin përdoret eufemizmi *ka le me këmishë*; për një fëmijë që flet shumë, në Çegran të Gostivarit përdoret eufemizmi *bën si radioni preshtë, bon si trakateshk*; për atë që qanë shumë thuhet: *ja kanë fug vajin, ruhet nga shtrigat*.

¹⁰ Shih: Tomor Osmani- Simon Pepa, *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Shkodër, 2000, f.45

¹¹ Po ata, po aty

¹² Po ata, po aty

Fëmija deri në çastin kur qethet për herë të parë quhet *famull*¹³. Për fëmijën që vdes thuhet: *na shkreti, naj thau gjepin* (Çegran, Llapushnik, Çajlë, Vrapçisht etj.). Lidhur me lipësin, përdoren eufemizmat: *ai i derës (përderës), kërkonjës* (që e hasim te Sh. Gjeçovi)¹⁴, *dertliu, zortliu* (Gostivar me rrethinë). Profesor Çabej¹⁵ ka theksuar se eufemizmi *përderës* përdoret edhe tek autorët e vjetër, ndërkaq, po sipas tij në Gjirokastër dëgjohej eufemizmi: *zonjë e varfër*. Në Pollog me rrethinë përdoren shpesh edhe shprehjet: *paç façen e bardhë, të xhetët e mera*, kur i pritet biseda thuhet: *t'i prefsha të kçiat*; kur preket pa dashur dikush me dorë duke biseduar i thuhet: *mos të preksha për të keq*, sikurse në Shkodër e Kosovë; kur zihen dy vetë thuhet: *e përmlodha mirë*, në vend e shava (Gostivar, Tetovë me rrethinë).

Edhe për organet e trupit të njeriut, për procese fiziologjike të ndryshme përdoren mjaft eufemizma, si: *namuzi* “organet gjenitale”, *nannuse* “emër i një zorre ngjitur me plëndësin, sipas Gj. Shkurtajt¹⁶. Etimologjia popullore shpjegon se fjala *nanuqi* dhe në formën dialektore *nantnuse* vjen nga *nantë nuse* “nëntë nuse”, sepse ka një përbërje të tillë xhepa-xhepa që mezi pastrohet, prandaj edhe legjenda se atë organ të kafshës kanë sprovuar ta lajnë nëntë nuse dhe nuk e kanë arritur ta pastrojnë si duhet. Profesor Çabej përmend në fillim eufemizma, si: *zakonet, nishanet, lulet, ato të bardhat, hadetet* për të përmuajshmet a menstruacionet¹⁷.

Në Gostivar me rrethinë përdoren eufemizmat e tipit: *o valavet, o mbush*; kur fëmija ndihet në bark. krhs. *asht zhyt* (Pejë). Kur fëmija ka zënë morra: *asht flliç, o krem, ka asi shokësh*, sikurse edhe në shumë vise tjera shqiptare. Këtu, sigurisht, mund të përfshihen edhe togfjalëshat foljore: *dal për vetin, dal për vedin* të anëve të Mbishkodrës, me kuptimin “kryej nevojat vetjake: urinoj ose defekoj”, që na i ka kumtuar akademik Shkurtajt.

Për VC-në, përdoren shprehjet: *aty ku është veni, aty ku shkon mreti n kambë, shkoi të dal jashtë, shkoj t'lirohet* (Pollog). Në Mirditë, sipas Gj. Shkurtajt thonë: “po dal me pa motin”, ndërsa kohët e fundit, sidomos në mjediset intelektuale, thuhet: *po shkoj të mbledh lule*. Kur është fjala për nevojë të vogël thuhet: *shkoj të derdh një ujë, shkoj për të voglën, shkoj t'prishi abdes* (Pollog - Maqedoni e Veriut). Me vese njerëzore lidhen eufemizmat: *tamaqar* për lakmitarin, *zemërlepër* për frikacak, *i ngratë, me skame*; për i varfër.

Për jashtëqitjen në Vrutok të Gostivarit përdoret shprehja: “*e ka kap vozia*”, “*e çet zemra, e çet skita*”; në vise të tjera shqiptare dëgojmë edhe shprehjet: *shkulzëzë, baltheqën, shkulon* për at që e qet barku, sipas T. Osmanit e Simon Pepës. Kur burri hyn për t'u larë, thuhet: *do hyj të fugi ni kov ujë, t'i fug trupit ni pek ujë* (Çegran, Forinë, Balindoll, Çajlë etj) Krhs.: *po hy me la kriet*¹⁸ (Gollak - Kosovë); për një vajzë të pamartuar në moshë të madhe thuhet: *vajzë e ndejme, vajzë e n(d)ejun*; për gruan me barrë, përdoret eufemizmi zbutës: *është e rond, është shtatëzënë, është me bark, është me moull(mall)* (Ohër). Kur dy gra janë të martuara me një burrë ata e thërrasin njëra-tjetrën *ortake, shoqe*, krhs. *shoqe*¹⁹ në (Pollog me rrethinë, Reç – Dardhë – Dibër).

Një gruajë të keqe i thonë *virane*, ndërsa në Jug e njëjta thirret me sinonimin zbutës *çapkëne*. Një eufemizëm i tillë përdoret edhe te popujt e tjerë. Në Pollog me rrethinë, për gruen e keqe (e ligë) përdoret shpesh shprehja eufemistike: *shkon terma – teposhtë, nuk është xhis, nuk është soj mer, është e asaj dore*. Po kështu gruaja e martuar me një të ve-vejan, fëmijën e burrit e quan *djal burri*, në Mbishkodër, sipas Gj. Shkurtajt, edhe *djal i gjetun*. Një të plagosuri i thonë “*i shitaum*” (Dobridoll, Sanakos, Negotinë - Gostivari). Në shumë lokalitete të Pollogut kunatit i thonë *lalë*, krhs. *lalëbukur*²⁰ tek arbreshët e Italisë.

¹³ Po ata, po aty

¹⁴ Sh. Gjeçovi, Buka, krypa, zemra “Bota shqiptare”, Tiranë, 1943, f. 357

¹⁵ E. Çabej “Studime gjuhësore” I, Prishtinë, 1976, f. 53

¹⁶ Gj. Shkurtajt, *E folmja e Kastratit*, S.F., 3, 1967, f. 54

¹⁷ E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, f. 319

¹⁸ Po ata, po aty, f. 48

¹⁹ B. Beci, *E folmja e Reç-e-Dardhës*, S.F. nr. 1, 1965, f. 90

²⁰ T. Osmani-S. Pepa, *Tabu*.....f. 49

Në Çegran e Forinë të Gostivarit, nipi e thirr vëllaun e babës: *puç*. Një dukuri e veçantë gjuhësore ndër shqiptarët e Pollogut të Maqedonisë së Veriut është edhe mospërmendja e emrit të bashkëshortes. Pra, emri i bashkëshortes është shndërruar në tabu. Kështu, përgjithësisht tek shqiptarët e këtyre zonave, emërtimi i bashkëshortes bëhet në bazë të emrit të burrit, duke ia prapavënë emrit të burrit prapashtesën sllave *-icë>i:c*, apo variantin e diftonguar *-áic*, si p.sh.: Besim>Besimicë, Belul>Belulicë, Nezir>Neziricë, Arif>Arificë; por edhe: Nehat>Nehataic, Rihan > Rihanaic etj.

Edhe emri i burrit në ca raste është shndërruar në tabu. Gruaja nuk e thërret burrin në emër por përdor shprehjet: *o njeri, a xhexhën, more, o plak*. Kur bisedon me ndonjë për të: *ai i jemi, burri jem, plaki (plaku) jem, ai, ki malli jem* (Zherovjan, Bogovinë, Dobërdoll – Tetovë). Ndërkaq, burri e thërret gruan me shprehjen: *mori, a xhexhën mi, oj tej* etj., krhs. *a ndjeve*; kur bisedon me ndonjë për gruan e vet, thotë: *ajo e jemja, ajo, niqahi jem*, (Pollog me rrethinë), por edhe: *plaka jeme, robi jem*²¹.

Siç kanë vërejtur akademik Mark Krasniqi e më pas studuesit Tomor Osmani e Simon Pepa “ky zakon është shumë i vjetër ndër popujt e ndryshëm”. Qysh në kohën antike Herodoti shkruante se gratë e jonëve nuk i thërritnin burrat e vet me emrin e tyre të vërtetë. Ngjashëm si në disa lokalitete të Kosovës dhe të Shqipërisë, në Gostivar me rrethinë, burri për gruan u thotë fëmijëve: *nëna juaj, fKate nënën tuaj*; në Kërçovë dhe në Çajllë të Gostivarit: *dadën (thirre dadën tuaj)*; ndërsa kur gruaja flet për burrin e vet u thotë fëmijëve me perifrazime, si : *a është baba ju (juaj) në shpe* (shtëpi).

Përfundim

Nga sa u tha më sipër mund të përfundojmë se, eufemizmat janë dukuri gjuhësore e përditshmërisë sonë, të cilat, ndonëse mendohej se u përkasin kohëve të vjetra dhe mjediseve e situatave kryesisht analfabete e të prapambetura, megjithatë, mund të shihet se ato, jo vetëm nuk kanë shteruar, por edhe po shtohen me formime a sajesa të reja. Kështu, sot dëgjojmë të thuhet shpesh shprehja eufemistike “*nuk është fort mirë më shëndet*” në vend të “është i sëmurë”, ashtu edhe “*u nda prej nesh*” në vend “*vdiq*” etj. Rëndësia e tyre është tepër e madhe për jetën dhe komunikimin ndërnjëzësor.

Referencat

- [1]. Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999.
- [2]. Gjovalin Shkurtaç, *Vështrim sociolinguistik për fjalët zot, perendi, allah* (Sprovë për një shqyrtim paraprak), në “Sociolinguistika”, SHBLU, Tiranë, 2003.
- [3]. Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004.
- [4]. Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes, Nga sociolinguistika te etnografia e të folurit*, Tiranë, 2009.
- [5]. Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Kastriotit*, S.F., 3, 1967.
- [6]. Brown & Lewinson, *Politeness: some universals in language usage*, Cambridge, 1987.
- [7]. B Apte, *Taboo Words*, në: *Concise Encyclopedia of Pragmatics*, Amsterdam, 1998.
- [8]. Bugarski R., *Jezik u drushtvu*, Beograd, 1986.
- [9]. Eqrem Çabej “*Studime shqiptare*” I, III, Prishtinë, 1976.
- [10]. Tomor Osmani - Simon Pepa, *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Shkodër, 2000.
- [11]. Shtjefan Gjeçovi, *Buka, krypa, zemra “Bota shqiptare”*, Tiranë, 1943.
- [12]. Bahri Beci, *E folmja e Reç-e-Dardhës*, S.F.nr.1, 1965.
- [13]. Mark Krasniqi, *Antroponimia e Kosovës në dritën e shkencave etnografike*, Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979.

²¹ Mark Krasniqi, *Antroponimia e Kosovës në dritën e shkencave etnografike*, “Onomastika e Kosovës”, Prishtinë, 1979, f. 103